

V E N D I M
Nr.479 datë 16.9.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.276, DATË 30.6.1992 "PËR ORGANIZIMIN, PRITJEN, SHPËRNDARJEN
DHE ADMINISTRIMIN E NDIHMAVE SHTETËRORE"

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.276, datë 30.6.1993 "Për organizimin, pritjen, shpërndarjen dhe administrimin e ndihmave shtetërore", në kreun I të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë në kreun I ndryshohet si vijon:

"Për organizimin e punës për sigurimin në kohë të artikujve ushqimorë për furnizimin e popullit nëpërmjet ndihmave që i akordohen shtetit shqiptar nga shtetet dhe organizmat e ndryshme ndërkombëtare, blerjeve me kredi shtetërore, me fonde valutore të buxhetit dhe burimeve të tjera, si dhe për pritjen dhe shpërndarjen e tyre, të merren këto masa:"

b) Në kreun I, në pikën (1), fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

"Komisioni të analizojë çdo muaj gjendjen e sigurimit e të shpërnarjes së mallrave kryesore ushqimore dhe të kërkojë marrjen e masave nga ministritë, institucionet e tjera qendrore e rrethet për plotësimin e detyrave që dalin".

c) Në pikën (2) paragrafi i parë, i dytë dhe i tretë ndryshohen si vijon:

"Të ngrihet grupi qendror i trajtimit të mallrave ushqimore që importohen për furnizimin e popullit, pjesërisht me shkëputje nga puna, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë me këtë përbërje:

1. Kryetar
2. Zv.kryetar
3. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë
4. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë
5. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit
6. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit
7. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë
8. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë
9. Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve
10. Tregshum Durrës
11. NTG Durrës
12. Policia Financiare

Në përbërje të grupit të jetë edhe një ekonomist, një përkthyes dhe një shofer. Grupi qendror i trajtimit të mallrave ushqimore që importohen për plotësimin e nevojave të popullit, ka këto detyra kryesore:"

ç) Në pikën (2), në detyrat e grupit qendror paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Paraqet në çdo kohë strukturën dhe sasitë e ushqimeve që mund të përfshihen në ndihmat që eventualisht jepen nga shtetet dhe organizmat e ndryshme ndërkombëtare, si dhe blerjet me kredi shtetërore, fonde valutore e burime të tjera".

d) Në pikën (2), në detyrat e grupit qendror , paragrafi i gjashtë, i shtatë dhe i tetë shfuqizohen.

dh) Në pikën (2) , në detyrat e grupit qendror, paragrafi i nëntë ndryshohet si vijon :

"Ndjek dhe realizon mbërritjen dhe shpërndarjen e ndihmave, blerjeve me kredi shtetërore, me fonde valutore e buxhetore dhe burime të tjera të mallrave ushqimore sipas artikujve dhe donatorëve, si dhe të ardhurat në buxhet nga shitja e tyre".

e) Pika (5) shfuqizohet.

2. Kreu II tërësisht ndryshohet si vijon:

"Për administrimin e ndihmave dhe blerjen me kredi, fonde valutore buxhetore dhe burime të

tjera, si dhe për arkëtimin e derdhjeve në buxhet të të ardhurave që realizohen nga shitja e tyre, të merren këto masa:

1. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të organizojë ndërmarrje të veçanta për trajtimin e artikullit grurë dhe miell.

Në zbatim të këtij vendimi, brenda strukturës organizative e financiare të planifikuar të NFIU-së Durrës, të krijohet ndërmarrja e re, duke e emërtuar NTG (Ndërmarrja e Trajtimit të Grurit).

2. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë për artikuj ushqimorë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për artikujt grurë dhe miell, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me grupin qendror të trajtimit të ndihmave ushqimore, hartojnë bilancin e nevojave ushqimore, përcaktojnë sasi të që do të importohen nga blerjet me kredi shtetërore, fonde valutore buxhetore e burime të tjera për çdo artikull, sasi të që do të kalojnë në rezervë të shtetit dhe sasi të për zonat që do të izoloohen nga dimri. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, mbi bazën e këtij përcaktimi, lëshojnë urdhrat e blerjes për Tregshum-in në Durrës dhe NTG në Durrës, sipas vartësisë. Për të gjitha rastet e blerjeve sipas përkatësisë së administrimit të strukturës së mallrave Tregshum-i në Durrës dhe NTG në Durrës organizojnë blerjet dhe shitjet sipas procedurave të prokurimit.

- Tregshum-i në Durrës kryen shitje me shumicë të artikujve ushqimorë subjekteve të ndryshme, sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave për prokurimin nëpërmjet ankandit.

- NTG në Durrës realizon shitjen e artikujve grurë dhe miell për subjektet shtetërore prodhuese të miellit e të bukës me çmime të ndryshueshme brenda atyre të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.273, datë 12.6.1993, pika l, kurse për subjektet private përdoruese të miellit dhe të bukës nëpërmjet ankandit, sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave për prokurimin.

3. Tregshum-i në Durrës për artikujt kryesorë ushqimorë dhe NTG në Durrës për artikujt grurë dhe miell janë realizuesit kryesorë të administrimit të blerjeve, pritjeve dhe shpërndarjes së tyre për të gjitha njoftimet që kryhen me fonde ndihmesh dhe kredish shtetërore, me fonde valutore të buxhetit dhe burime të tjera. Ata kontrollojnë dhe ndjekin realizimin e sasive të akorduara e të kontraktuara dhe mbajnë lidhje të drejtpërdrejta me dikasteret, donatorët përkatës dhe grupin qendror të ndihmave pranë Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë.

4. Për organizimin e pritjes, shkarkimit dhe shpërndarjes së artikujve ushqimorë që vijnë në rrugë detare ose tokësore, ndërmarrjet përkatëse me kontrata përcaktojnë kushtet e detyrimet e ndërsjellta që lindin ndërmjet tyre.

5. Në rast se organizimi i transporteve të mallrave bëhet nga Tregshum-i në Durrës dhe NTG në Durrës sipas strukturave përkatëse të trajtimit të mallrave, zgjedhja e specidioneve bëhet sipas procedurave të prokurimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

6. Kontrolli cilësor kryhet nga organizma ose institucione të njohura e të akredituara në fushat përkatëse dhe që disponojnë mjetet e nevojshme për kryerjen e kësaj detyre mbi bazën e kontratës. Në këtë rast zgjedhja mbështetet në kushtet e prokurimit.

7. Tregshum-i dhe NTG të marrin kredi bankare me objekt "Mallrat ushqimore nga ndihmat shtetërore me kredi shtetërore, fonde valutore buxhetore dhe blerje të tjera".

8. Ngarkohen të gjitha organizmat e kontrollit shtetëror të ndjekin administrimin e mallrave ushqimore që vijnë nëpërmjet ndihmave shtetërore, të blerjeve me kredi shtetërore dhe fonde valutore buxhetore dhe blerje të tjera dhe, për shkeljet që zbulojnë, të vendosen sanksione në pajtim me kompetencat që kanë".

3. Kreu III tërësisht ndryshohet si vijon:

"Marrëdhëniet ndërmjet portit detar, Tregshum-it në Durrës dhe NTG në Durrës, për dorëzimin e mallrave në portin e Durrësit, rregullohen si vijon :

1. Porti detar, për llogari të Tregshum-it për artikujt kryesorë ushqimorë dhe të NTG-së për grurë dhe miell, kryen ndaj subjekteve të tjera :

- shkarkimin e mallrave nga anija;

- depozitim të përkohshëm dhe administrimin e mallrave në magazinat e tyre, sipas nevojave që paraqiten.

2. Porti detar ua dorëzon mallrat ushqimore të importuara ndërmarrjeve të furnizimit me shumicë sipas përkatësisë dhe administrimit të tyre, si më poshtë:

- në mjetin e transportit, kur malli shkarkohet drejtpërdrejt nga anija në mjetin e transportit;

- në magazinat e portit;

- kur këto mallra janë depozituar përkohësisht në to.

3. Ndërmarrja e furnizimit me shumicë për mallrat që evadohen drejtpërdrejt nga anija me mjete transporti, i merr këto mallra në dorëzim në momentin e ngarkimit të tyre, me anë të përfaqësuesve të saj që qëndrojnë në kalatë, përgjatë anijes, të cilët shkëmbejnë firmat për marrjen në dorëzim të mallit për çdo bragë të dalë nga hambari i anijes, me spontatorët e portit. Në përfundim të ngarkimit të mjeteve të transportit përfaqësuesi i ndërmarrjes pritëse të mallit përpilon në kalatë me përfaqësuesin e portit dokumentin përfundimtar të marrjes së mallit në dorëzim nga porti.

4. Tregshum-i nga NTG-ja i paguan portit detar shpërblimin për shërbimet e kryera që janë përcaktuar në pikën III të këtij vendimi; pagesa e shpërblimit bëhet mbi bazën e tarifave të lira që ka porti për shërbimet që kryen.

5. Pas shkarkimit të mallit nga anija Tregshum-i dhe NTG-ja në portin detar bëjnë rakordimin me dokumente të sasisë së mallit të marrë në dorëzim nga anija, të sasisë së evaduar drejtpërdrejt nga porti dhe të sasisë së mallit që ndodhet i depozituar përkohësisht në port për llogari të Tregshumit dhe të NTG-së. Ky rakordim bëhet nga të tri palët, i dokumentuar me procesverbal.

6. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, përcakton afatin kohor të realizimit të fondit kundërpartit të ndihmave, si dhe nivelet tavan minimal të çmimeve të fondit kundërpartit për fillimin e ankandit dhe marzhet sipas hallkave që trajtojnë këto ndihma.

7. Bazat e tregtisë shtetërore ushqimore, ndërmarrjet e frigoriferëve në rrethe, si dhe ndërmarrjet e grumbullimit e të përpunimit të drithërave, krijojnë kushte për depozitim dhe ruajtjen e mallrave për subjektet private ose shtetërore që kanë fituar ankandin me Tregshum-in në Durrës dhe NTG. Kjo tarifë duhet të përballojë të gjitha shpenzimet e bazës pritëse, si dhe një fitim jo më të lartë se 10 për qind e këtyre shpenzimeve. Në këto raste nuk zbatohet tatimi mbi qarkullimin për tarifën e shërbimit.

8. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të nxjerrin udhëzime përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi